



# AKT - THEMELIMI

## I

### SHOQERISE ANONIME "GENKLAUDIS" SH.A.

#### Kreu 1

Ne mbledhjen e pare te Asamblese se Jashtezakoneshme te zhvilluar ne Beltoje, Komuna Berdice, Shkoder sot me daten 15.06.2007, une Aksioneri i vetem Themelues i Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A.:

Paulin GEGA, i biri i Pjetrit dhe i Rozes, me kombesi e shtetesi shqiptare, lindur me 20.08.1965 ne Beltoje, Shkoder dhe me banim: Beltoje, Komuna Berdice, Shkoder, identifikuar nepermjet Pasaportes Z1338303 date 04.03.2005, bazuar ne vullnetin tim te lire, te plote e te sinqerte perpilova dhe nenshkrova kete Akt Themelimi bazuar ne Legjislacionin Shqiptar:

Nr.7512 date 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit.

-Nr.7638 datë 19.11.1992 "Per shoqërite tregtare".

-Nr.7667 datë 28.1.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

-Nr.7764 date 2.11.1993 "Mbi investimet e huaja".

-Ne Kodin Civil, Doganor, Ne Legjislacionin Tatimor, Fiskal, Bankar, ate te Komunitetit European si dhe ne Aktin e Themelimit e Statutin e saj.

-Aktet e tjera nenligjore si dhe duke qene aksioner i vetem themelues e zoterues i te gjithe vleres se Kapitalit Themeltar te Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. pa Oferte Publike te caktuar.

#### Neni 1

Shoqeria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. ka emertimin e vet i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj, me te cilen do te paraqitet ne cdo dokumentacion dhe ne marrdhenie me te tretet.

Ne te gjitha Aktet dhe Dokumentet qe do te nxjerre Shoqeria ky emertim do te shoqerohet duke u shenuar ne te Selia Qendrore.

#### Neni 2

Aktivitetin e saj Shoqeria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. e shtrin ne te gjithë juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

#### Neni 3

Shoqeria "GENKLAUDIS" SH.A. ka Selinë e saj ne Beltoje, Komuna Berdice, Shkoder.

Me Vendim te Keshillit Mbikeqyres mund te celen, transferohen ose mbyllen dege e filiale si brenda dhe jashte shtetit, me kusht qe ky Vendim te miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese se Aksionereve.

#### Neni 4

Shoqeria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. eshte Person Juridik Shqiptar dhe aktivitetin e saj tregtar e bazon ne legjislacionin vendas.

*Handwritten signature*



#### Neni 5

Personalitetin juridik Shoqeria "GENKLAUDIS" SH.A. e fiton mbi bazen Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.  
Rregjistrimin e saj në Regjistrin Tregëtar të asaj Gjykate.

#### Neni 6

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë Anonime SH.A. "GENKLAUDIS" është me afat të pa caktuar.

Ky afat mund të ndryshojë me Vendim të Mbledhjes së Aksionereve.

Kohezgjatja e Shoqërisë Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. mbaron edhe përpara këtij afati me keto kushte:

a-Kur Shoqëria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. pushon veprimtarinë e saj, mbi bazën e Vendimit të mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionereve.

b-Sipas rasteve të tjera që parashikohen në dispozitat ligjore perkatëse në fuqi.

#### Neni 7

Kapitali Themeltar i Shoqërisë Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. është 2.500.000 (Dymiljoneepesëqindemije) leke i ndarë në Aksione me vlerë nominale 1.000 leke (Njemijeleke) për çdo aksion, gjithësej 2.500 aksione (Dymijepesëqindeaksione), ku një aksion përveç vlerës nominale në lek, ka edhe vlerën e një vote.

Kontributi financiar me krijimin e këtij kapitali formohet nga Aksioneri i vetëm themelues me anë të derdhjes së tyre tek Noteri:

Derdhja e kuotave është bërë si më poshtë:

Paulin Pjeter GEGA 2.500.000 leke (Dymiljoneepesëqindemijeleke) dhe ndahet në Aksione me vlerë nominale 1.000 leke (Njemijeleke) për çdo aksion, gjithësej 2.500 aksione (Dymijepesëqindeaksione).

#### Neni 8

Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve zotëruar të Aksioneve, merr vendim për zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, dhe ky vendim është i vlefshëm kur në këtë mbledhje marrin pjesë Aksionerët që zotërojnë  $\frac{3}{4}$  e aksioneve të pranishëm ose të përfaqësuar me prokurë dhe që kanë të drejtën e votes.

#### Neni 9

Objekti i veprimtarisë dhe qëllimi i Shoqërisë Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. është:

Import, eksport, tregëti me shumicë e pakicë të karburanteve, lubrifikanteve, vajrave, graso, gaz e lende djegëse të të gjitha llojeve dhe kategorive etj.

Ushtrimin e tregëtisë me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë, pajisje e materiale të ndryshme hidraulike e elektrike, dhe në përgjithësi çdo aktivitet plotësues.

75/8

Import dhe eksport mallra e paisje te te gjitha llojeve, makineri e paisje, si dhe aktivitetin e shperndarjes e te perdorimit te tyre, per vete Shoqerine dhe per te tjere.

Te kryej furnizime te impianteve dhe te paisjeve teknike per aktivitete qe operojne dhe qe kane lidhje me ato te shoqerise.

Shoqeria mund te kryej te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime objekte te ndryshme industriale e civile, prodhime inertesh e materiale ndertimi, financime, qe quhen te nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise, si dhe cdo veprimtari tjeter qe nuk bien ne kundershtrim me ligjin.

Shqeria do te kryej veprimtari ne fushen hotelerise, turizmit, ushqimit social, administrim i internet cafe, perfshire administrimin e aktiviteteve te lidhura me te si bar -kafe, sherbime fotokopje, shitje te vogla kancelerie dhe materiale te konsumit e aktivitete te tjera te ketij lloji.

Te hyje ne veprimtari afariste qe cojne ne realizimin e synimeve te saj.

Shoqeria mund te kryej drejtperdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesemarrje ne Shoqeri te tjera, te zhvilloje cdo lloj aktiviteti, qe lidhet dhe ne menyre indirekte me qellimet e Shoqerise e qe vleresohen te dobishme per arritjen e tyre.

Për këtë qëllim shoqëria ka të drejtë:

Të importojë, eksportojë dhe tregtojë makineri dhe pajisje e produkte te ndryshme te te gjitha llojeve.

Ti japë punë me porosi te tretëve për sherbime të ndryshme.

Te ofroje dhe te kryej sherbime e konsulenca ne fushen teknike dhe tregtare.

Të organizojë kurse formimi dhe specializimi.

#### SELIA

Shoqeria ka seline e saj ne Beltoje, Komuna Berdise, Shkoder.

Keshilli Administrativ mund te krijojë, modifikojë apo anullojë seli sekondare, agjensi dhe perfaqesi kudo qe e quan te nevojshme, edhe jashte shtetit.

Qendra fiskale e ortakeve, persa u perket raporteve te tyre me shoqerine, eshte selia e shoqerise.

#### Neni 10

Shoqeria administrohet nga Drejtoria:

1-Drejtoria perbehet nga Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise.

Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. emerohet Zoti Paulin Pjeter GEGA.

2-Drejtoria ushtron funksionin e saj nen kontrollin e Keshilli Mbikqyres.

3-Anetaret e Drejtorise jane persona fizik dhe emerohen nga Keshilli mbikqyres me mandat, i cili ka nje kohe zgjatje periudhe kohore 4 (kater) vjet.

4-Anetaret e Drejtorise mund te shkarkohen per shkaqe te perligjura nga Keshilli Mbikqyres.

Si shkaqe te perligjura konsiderohen faji i rende i anetarit te Drejtoris, pa aftesia e tij ne kryerjen e funksionit, ose kur Asambleja humbet besimin tek ai.

Menyra dhe masa e shperblimit te sejcilit Anetar te Drejtorise caktohet ne momentin e emertimit.

*P. G. G. P.*



Neni 11

Te drejtat dhe detyrat e Organeve Drejtuese te Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. ne menyre te specializuar jane ato te percaktuara ne Statutin e saj.

Neni 12

Shoqeria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. cel Llogari Bankare ne leke dhe ne cdo lloj valute te huaj, ne banka vendase e te huaja, shtetore ose private per ushtrimin e rregullt te veprimtarise financiare te saj.

Aksioneri themelues depoziton firmen e tij ne Bankat ku eshte celur llogaria e Shoqerise, dhe terheqja e pjeseve te tij per nevojat e Shoqerise behet vetem me firmen e Drejtorit ose te autorizuarit te tij, ndersa transferimi i plote ose i pjesshem i kapitalit themeltar, behet kur nenshkruhet nga Aksioneri/et dhe shoqerohet me Akt Noterial.

Shoqeria dhe te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo tu behen te ditura.

Neni 13

Aktiviteti ekonomik - financiar i Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. ndahet ne periudha te cilat zgjasin 12 muaj, kohe e cila si rregull fillon nga data 1 Janar deri me daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te periudhes se pare, e cila fillon me daten e themelimit te Shoqerise.

Neni 14

Shoqeria duhet te mbaje nje kontabilitet te rregullt per administrimin e pasurise dhe gjithë veprimtarine ekonomik - financiare te saj ne pajtim me kerkesat e Ligjit perkates.

Bilanci financiar i Shoqerise nxirret mbi bazen e raportit me shkrim te Ekspertit Kontabel te Autorizuar dhe atij te paraqitur nga Drejtori i Pergjithshem, brenda dates 31 Dhjetor te vitit pasardhes dhe ato i paraqiten dhe miratohen me Vendim me shkrim nga Mbledhja e Asamblese se Aksionereve.

Fitimi Neto (Dividenti) i Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A., perlllogaritet mbasi nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, te jene zbritur humbjet e nevojshme te vitit te me parshem, vlera e shlyerjes se plote te detyrimeve Taksuale, Tatimore apo Fiskale, e cdo lloj detyrimi tjetër i Shoqerise ndaj te treteve, si dhe lenien menjane te nje shume te pakten 1/20 te fitimit te rezervuar e cila destinohet per formimin e nje Fondi reserve, te quajtur "Rezerve e Domosdoshme".

Ky fitim ndahet ne mes Aksionereve, sipas perqindjes qe ze kontributi i tyre ne krijimin e kapitalit themeltar.

Neni 15

Shoqeria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. mbaron si Person Juridik ne keto raste:

1-Me plotesimin e afatit te parashikuar kur ajo eshte krijuar.

2-Me Vendim te Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakoneshme te aksionereve te saj, sipas kushteve ligjore te ushtrimit te ksaj te drejte Vendimore.

3-Kur vertetohet nje nga rastet e parashikuara ne Ligjin per falimentimin e Shoqerive Aksionere.

Me mbarimin si Person Juridik Shoqeria kalon ne likujdim.

✓ GJP

Vendimi i likujdimit te Shoqerise i marre si mbi bazen e mbledhjes se Asamblese se Jashtezakoneshme te Shoqerise apo ne Ligj, u behet i njohur te gjith aksionereve, zoterues te aksioneve te Shoqerise nepermjet Publikimit te kësaj vendimi me mjetet e informimit publik dhe duke respektuar te gjitha procedurat ligjore.

Te ardhurat e arketuara nga Likujdimi i Shoqerise pas shlyerjes se cdo detyrimi, ndahen ne mes Aksionereve sipas vleres se kontributit te tyre ne formimin e Kapitalit Themeltar.

Neni 16

Perberja e Drejtorise

Drejtor i Pergjithshem e hte emruar Zoti Paulin Pjeter GEGA.

Neni 17

Keshilli mbikeqyres

Ne mbledhjen e pare te Asamblese se Jashtezakoneshme te Ortakeve Themelues te Shoqeria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. me votim unanim dhe 100% te votave, ajo Vendos zgjedhjen e Organeve Drejtuese te saj dhe konkretishte:

Keshilli Mbikeqyres i perbere nga 3 (tre) veta

-Donike GEGA Kryetare

-Fran STERKAJ N/kryetar

-Ardian STERKAJ Anetar

Neni 18

-Emerohet Eksperti kontabel i miratuar Zoti Hazis DRAGOVEJA.

Neni 19

-Akti i Themelimit miratohet unanimishte ne mbledhjen e pare te Asamblese se Jashtezakoneshme te Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A., mbi bazen e vullnetit te lire, te plote, te perbashket dhe me mirkuptim te ndersjellte.

Cdo mosmarrveshje si rregull Aksioneret themelues do ta zgjidhin ne mirkuptim mes tyre, ne te kundert ata kane te drejten ta bejne Objekt Konflikti Gjyqesor ne Gjykatën Kompetente te Juridiksionit tokesor e lendor te Shoqerise

Neni 20

Ky Akt Themelimi per krijimin e Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. u perpilua ne 4 (kater) kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen Shqipe, nenshkruhet pa vrejte nga Aksioneri i vetem Themelues, duke vene: emrin, mbiemrin dhe nenshkrimin origjinal ne te gjitha kopjet, Autentiteti i te cilave eshte i vertetuar ligjesishte nga Noteri.

Aksioneri i vetem Themelues ne Mledhjen e pare te Asamblese se  
Pergjithshme te  
Shoqerise Anonome "GENKLAUDIS" SH.A.

Paulin Pjeter GEGA

PAULIN GEGA

P. GEGA

Shkoder me, 15.06.2007



# STATUTI

## I

### SHOQERISE ANONIME "GENKLAUDIS" SH.A.

#### Kreu 1

Ne mbledhjen e pare te Asamblese se Jashtezakoneshme te zhvilluar ne Beltoje, Komuna Berdice, Shkoder sot me daten 15.06.2007, une Aksioneri i vetem Themelues i Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A.:

Paulin GEGA, i biri i Pjetrit dhe i Rozes, me kombesi e shtetesi shqiptare, lindur me 20.08.1965 ne Beltoje, Shkoder dhe me banim: ne Beltoje, Komuna Berdice, Shkoder, identifikuar nepermjet Pasaportes Z1338303 date 04.03.2005, bazuar ne vullnetin tim te lire, te plote e te sinqerte perpilova dhe nenshkrova kete Statut bazuar ne Legjislacionin Shqiptar:

Nr.7512 date 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit.

-Nr.7638 datë 19.11.1992 "Per shoqërite tregtare".

-Nr.7667 datë 28.1.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

-Nr.7764 date 2.11.1993 "Mbi investimet e huaja".

-Ne Kodin Civil, Doganor, Ne Legjislacionin Tatimor, Fiskal, Bankar, ate te Komunitetit Europian si dhe ne Aktin e Themelimit e Statutin e saj.

Aktet e tjera nenligjore si dhe duke qene aksioner i vetem themelues e zoterues i te gjithe vleres se Kapitalit Themeltar te Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. pa Oferte Publike te caktuar.

#### Neni 2

##### Emertimi i Shoqerise

Shoqeria ka emrin e saj Shoqeria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A., i cili do te jete i stampuar ne vulen e saj dhe me te cilen do te paraqitet ne cdo dokumentacion ne marredhenie me te tretet.

#### Neni 3

##### Selia e Shoqerise

-Shoqeria "GENKLAUDIS" SH.A. ka Selinë e saj ne Beltoje, Komuna Berdice, Shkoder.

-Me Vendim te Asamblese se Pergjithshme te Akacionereve, Selia e Shoqerise mund te transferohet ne cdo Bashki apo Komune te Shtetit Shqiptar.

-Me Vendim te Keshillit Mbikqyres Shoqeria mund te krijoje dhe te mbaje Dege te saj ose Zyra dhe te percaktoje perfaqesues dhe ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise ose jashte saj.

Kushtet e funksionimit te tyre si dhe veprimtarine e saj i cakton Keshilli Mbikqyres me Vendimin e tij perkates per krijimin e tyre.

8/07/07

#### Neni 4

Objekti i veprimtarise dhe qellimi i Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS"

SH.A. eshte:

Import, eksport, tregeti me shumice e pakice te karburanteve, lubrifikanteve, vajrave, graso, gaz e lende djegese te te gjitha llojeve dhe kategorive etj.

Ushtrimin e tregetise me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, paisje e materiale te ndryshme hidraulike e elektrike, dhe ne pergjithesi cdo aktivitet plotesues.

Import dhe eksport mallra e paisje te te gjitha llojeve, makineri e paisje, si dhe aktivitetin e shperndarjes e te perdorimit te tyre, per vete Shoqerine dhe per te tjere.

Te kryeje furnizime te impianteve dhe te paisjeve teknike per aktivitete qe operojne dhe qe kane lidhje me ato te shoqerise.

Shoqeria mund te kryej te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime objekte te ndryshme industriale e civile, prodhime inertesh e materiale ndertimi, financime, qe quhen te nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise, si dhe cdo veprimtari tjeter qe nuk bien ne kundershtrim me ligjin.

Shqeria do te kryej veprimtari ne fushen hotelerise, turizmit, ushqimit social, administrim i internet cafesc, perfshire administrimin e aktiviteteve te lidhura me te si bar -kafe, sherbime fotokopje, shitje te vogla kancelerie dhe materiale te konsumit e aktivitete te tjera te ketij lloji.

Te hyje ne veprimtari afariste qe cojne ne realizimin e synimeve te saj.

Shoqeria mund te kryej drejtperdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesemarrje ne Shoqeri te tjera, te zhvilloje cdo lloj aktiviteti, qe lidhet dhe ne menyre indirekte me qellimet e Shoqerise e qe vleresohen te dobishme per arritjen e tyre.

Për këtë qëllim shoqëria ka të drejtë:

Të importojë, eksportojë dhe tregtojë makineri dhe pajisje e produkte te ndryshme te te gjitha llojeve.

Ti japë punë me porosi te tretëve për sherbime të ndryshme.

Te ofroje dhe te kryej sherbime e konsulenca ne fushen teknike dhe tregtare.

Të organizojë kurse formimi dhe specializimi.

#### SELIA

Shoqeria ka seline e saj ne Beltoje, Komuna Berdice, Shkoder.

Keshilli Administrativ mund te krijojë, modifikoje apo anulloje seli sekondare, agjensi dhe perfaqesi kudo qe e quan te nevojshme, edhe jashte shtetit.

Qendra fiskale e ortakeve, persa u perket raporteve te tyre me shoqerine, eshte selia e shoqerise.


#### Neni 5

Forma e shoqerise do te jete: Shoqeri Anonime pa Oferte publike.

#### Neni 6

Emertimi i Shoqerise Anonime do te jete "GENKLAUDIS" SH.A.

*[Signature]*



#### Neni 7

##### Afati i Shoqerise

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. është me afat të pa caktuar.

Ky afat mund të ndryshojë me Vendim të Mbledhjes së Aksionereve.

Kohezgjatja e Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. mbaron edhe përpara këtij afati me keto kushte:

a-Kur Shoqeria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. pushon veprimtarinë e saj, mbi bazën e Vendimit të mbledhjes së Asamblese së Jashtëzakonshme të Aksionereve.

b-Sipas rasteve të tjera që parashikohen në dispozitat ligjore përkatëse në fuqi.

Me Vendim të Asamblese së Përgjithshme të Aksionereve, në mbledhjen e saj të jashtëzakonshme, të miratuar me  $\frac{3}{4}$  e votave të shumicës së aksionereve mund të zgjatet ose të zvogëlohet afati i veprimtarisë së Shoqerise.

#### Kreu i dytë

##### Kapitali Themeltar, Aksionet

##### Kapitali fillestar

#### Neni 8

Kapitali Themeltar i Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. caktohet në shumën 2.500.000 leke (Dymiljoneepesëqindemijeleke) dhe ndahet në Aksione me vlerë nominale 1.000 leke (Njemijeleke) për çdo aksion, gjithsej 2.500 aksione (Dymijepesë qindeaksione), ku një aksion përveç vlerës nominale në lek ka edhe vlerë të një vote.

Kontributi financiar me krijimin e këtij kapitali formohet nga Aksioneri i vetëm themelues me anë të derdhjes së tyre tek Noteri:

Derdhja e kuotave është bërë si më poshtë:

Paulin Pjeter GEGA 2.500.000 leke (Dymiljoneepesëqindemijeleke) dhe ndahet në Aksione me vlerë nominale 1.000 leke (Njemijeleke) për çdo aksion, gjithsej 2.500 aksione (Dymijepesëqindeaksione).

#### Neni 9

##### Aksionet

-Aksionet e Shoqerise janë aksione nominale.

-Organi kompetent për rregullimin e formës, tipit të titullit të aksionit, dhe leshimit (nxjerrjes) të tyre është Këshilli Mbikqyres, sipas gjykimit të të cilit aksionet mund të dalin në formën e titujve që përfaqësojnë një ose më shumë aksione.

-Aksionet janë gjithnjë për kontribut në para dhe shlyhen plotësisht me nënshkrimin e tyre.

-Aksionet e Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. qofte aksione nominale mund të transferohen lirisht në çdo moment ndërmjet aksionereve të Shoqerise apo ndërmjet aksionereve të filialeve të Shoqerise.



-Transferimi i pronesisë së aksionit normative të një personi të tretë për çdo lloj arsye, me përjashtim të rastit të kalimit të pronesisë nga trashëgimia miratohet nga Asambleja e Jashtëzakonshme e Akacionereve të Shoqërisë sikurse parashikohet në Statut.

-Çdo veprim tjetër për transferimin e pronesisë së Aksionit Normativ një personi të tretë, Aksioneri apo aksioneret që dëshirojnë të kalojnë një pjesë apo të tëra aksionet e tyre një personi të tretë, detyrohen të parashtrijne kërkesën përkatëse në Këshillin Mbikqyres të Shoqërisë, e cila duhet të përmbajë numurin e akcioneve që do të transferohen, vlerën e tyre nominale, të dhënat e dokumentit të identitetit dhe adresën e personave të tretë tek të cilët do të bëhet kalimi i pronesisë së aksioneve si dhe cmimin e mënyrën e pagesës që ofrojnë personat e tretë për blerjen e aksioneve në fjalë.

Në këtë rast Këshilli Mbikqyres detyrohet të thërresë Asamblenë e Jashtëzakonshme të Akacionereve për miratimin e transferimit të aksioneve personave të tretë.

Neqoftesë Asambleja e Jashtëzakonshme e Akacionereve nuk merr Vendim mbi këtë çështje duke mos iu përgjigjur kërkesës së drejtuar, brenda afatit të 3 (tre) muajve nga parashtrimi i kësaj kërkesë transferimi i aksioneve personave të tretë quhet i miratuar.

Neqoftesë Asambleja e Jashtëzakonshme e Akacionereve nuk miraton kërkesën me pësmarrjen me shumicën e duhur të aksionereve; blerja e aksioneve, qoftë nga aksionet e tjera të cilët dëshirojnë të pronesojnë aksionet që ofrohen, apo nga persona të tretë, të cilët do të miratohen nga Asambleja e Jashtëzakonshme e re që do të mbledhet apo edhe nga vete Shoqëria me zvogelimin analog të kapitalit me Vendim të Asamblese së Jashtëzakonshme duhet të perfundojnë brenda afatit të 3 (tre) muajve nga dita e marrjes së Vendimit jo aprovues nga Asambleja.

Në rastin e mosmarrvëshjes së dy paleve përsa i përket cmimit të blerjes së aksioneve, ky cmim caktohet në përputhje me dispozitat e nenit 11 të Ligjit Nr.7638 datë 04.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare".

Vlerësimi bëhet nga ekspert i posacem, i cili caktohet nga palet e interesuara.

Neqoftesë pereseri palet nuk bien dakort, mosmarrvëshja do të zgjidhet detyrimisht nga Gjykata kompetente, sipas Nenit 12 të Ligjit Nr.7638 datë 4.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare".

Në çdo rast të transferimit të aksioneve nominale personave të tretë, transferimi është i vlefshëm për Shoqërinë nga momenti i rregjistrimit në rregjistrin e aksioneve që mban për këtë qëllim Shoqëria, i cili përmban të dhëna të hollësishme në lidhje me transferimin e pronesisë së aksioneve si më poshtë:

-datën e operacioneve  
-emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit të titullarit të më poshtëm dhe atij të ri në rast transferimi.

-emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të titullarit të aksioneve në rastin e shënderrimit të aksioneve për pruresin në aksione nominative.

-vlerën nominale dhe numurin e aksioneve të transferuar apo të shënderruar.

-Aksionet nominative mund të shënderrohen në aksione për pruresin me vendim të Asamblese së Përgjithëshme.

2.5.15

-Aksionet e Shoqerise jane te pakthyeshme per kundrejte shoqerise.  
-Pergjegjësia e Aksionerit kufizohet ne kapitalin nominativ te aksioneve te tij.  
-Cilesia e aksionit dhe e posedimit te titullit te aksionit eshte rrjedhoje e pranimi te ketij Statuti, ndryshimeve te mundeshme te tij ne baze te Ligjit dhe Vendimeve te Asamblese se Pergjitheshme.  
Cdo aksion i jep te drejten e nje vote te vetme ne Asamblene e Pergjitheshme.

#### Neni 10

-Kapitali fillestar i Shoqerise mund te zmadhohet vetem me Vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme se Pergjitheshme te Aksionereve.

Ky vendim merret me shumicen e parashkuar ne Statut.

-Zmadhimi i kapitalit fillestar te Shoqerise behet me emetimin e aksioneve te reja apo me rritjen e vlefes nominale te aksioneve ekzistuese.

Zmadhimi i kapitalit fillestar me rritjen e vlefes nominale te aksioneve ekzistuese behet me vendimit unanim te aksionereve, me perjashtim te rastit kur zmadhimi i kapitalit fillestar behet me perfshirje te rezervave, te fitimeve apo te primeve te emetimit, keshu qe mjafton shumica dhe kuorum i thjeshte i votave ne mbledhjen e zakonshme te Asamblese se Pergjithshme.

-Zmadhimi i kapitalit fillestar duhet te realizohet brenda afatit te 5 (pese) vjeteve, qe nga dita qe Asambleja e Pergjithshme ne mbledhjen e jashtezakonshme mori vendimin perkates.

-Mbledhja e jashtezakonshme e Asamblese se Pergjithshme, e cila vendos per zmadhimin e kapitalit cakton gjithashtu edhe afatin e ushtrimit te se drejtes parapëlqyese, i cili nuk mund te jete me i vogel se 20 (njetete) dite qe nga data e celjes se nenshkrimit.

-Shoqeria perpara celjes se nenshkrimit ploteson formalitetet e publikimit, modalitetet e te cilave percaktohen me ligj te vecante.

Gjithshtu kontrata e nenshkrimit pasqyrohet ne buletin e hartuar sipas kushteve qe pasqyrohen me ligj te vecante.

-Pjesa e zmadhimit te kapitalit te cilin e marin persiper ta mbulojne aksioneret e rinj apo te vjeter duhet te shlyhen gjate nenshkrimit te pakten deri ne nje te katerten e vleres se tyre nominale me dhenien njekohesishte te premtimit nga aksioneret per shlyerjen e vlefes se mbetur brenda afatit, i cili nuk mund te jete me i madh se 2 (dy) vjet.

Perpara se te behet cdo emetim aksionesh te reja qe shlyhen me para ne dore duhet qe kapitali te jete shlyer plotesishte perndryshe operacioni konsiderohet i pavlefshem.

-Mbledhja e asamblese se Jashtezakonshme e cila vendos per zmadhimin e kapitalit mund te heqe te drejten e perparësise se nenshkrimit.

Vendimi merret me shumicen dhe pjesemarrjen apo parashikohen nga Neni 26 i ketij Statuti.

Qe vendimi i Asamblese te jete i vlefshem duhet te merret mbi bazen e raportit te Drejtorise dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

#### Neni 11

-Ne rast se aksioneret te cilet perfaqesojne 1/20 e kapitalit fillestar me kerkese te tyre kerkojne thirrjen e mbledhjes se jashtezakonshme te Asamblese, Keshilli Mbikqyres eshte i detyruar ta therrase ate duke caktuar

26-17

diten e mbledhjes, jo me larg se 30 (tridhjetë) dite nga dita e parashtrimit te kerkeses tek kryetari i Keshillit Mbikqyres.

-Ne kerkese duhet te percaktohet me saktësi objekti i rendit te dites.

-Duke filluar nga momenti i lajmerimit per mbledhjen vjetore te Asamblese se zakonshme dhe te pakten 15 (pesëmbëdhjetë) dite para fillimit te saj cdo aksioner apo mandatmbajtes i emruar prej tij si perfaqesues ne Asamble ka te drejte ne seline e Shoqerise te njihet me:

-Inventarin, bilancin financiar vjetor dhe listen e anetarve te Drejtorise dhe te Keshillit Mbikqyres.

-Raportet e Drejtorise se Keshillit Mbikqyres dhe eksperteve kontabel te autorizuar qe do ti paraqiten asamblese per shqyrtim.

-Tekstin dhe argumentet e rezolutave te propozuara si dhe te dhenat mbi kandidatet per ne Keshillin Mbikqyres.

-Listen me emrat e Aksinereve te Shoqerise.

-Cdo aksioner ka te drejte te kerkoje te vihen ne dispozicion fotokopje te shkresave dhe te te dhenave te cilat permenden ne paragrafin e mesiperme dhe kane te bejne me 3 (tre) vjetet ekonomike te fundit.

-Nje ose disa anetare qe perfaqesojne te pakten 1/10 e kapitalit themeltar kane te drejten qe brenda nje afati prej 30 (tridhjetë) ditesh nga data e caktimit te kundershtojne ne gjykate nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar qe do te ushtrojne verifikimin ne vend te tyre.

-Aksineret e Shoqerise qe perfaqesojne te pakten 1/10 e kapitalit themeltar kane te drejten dy here per cdo vit financiar ti paraqesin Drejtorise pyetje me shkrim ne lidhje me cdo problem qe kompromenton vazhdueshmerine e Shoqerise.

-Pergjigja i komunikohet ekspertit kontabel te autorizuar.

Kreu III  
Drejtoria  
Neni 12

Shoqeria administrohet nga Drejtoria:

Drejtoria perbehet nga Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise.

Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. emerohet Zoti Paulin Pjeter GEGA.

-Drejtoria ushtron funksionin e saj nen kontrollin e Keshilli Mbikqyres.

-Anetaret e Drejtorise jane persona fizik dhe emerohen nga Keshilli mbikqyres me mandat, i cili ka nje kohe zgjatje periudhe kohore 4 (kater) vjet.

-Anetaret e Drejtorise mund te shkarkohen per shkaqe te perligjura nga Keshilli Mbikqyres.

-Si shkaqe te perligjura konsiderohen faji i rende i anetarit te Drejtoris, pa aftesia e tij ne kryerjen e funksionit, ose kur Asambleja humbet besimin.

Menyra dhe masa e shperblimit te sejcilit Anetar te Drejtorise cakrohet ne momentin e emertimit.

Neni 13

Kompetencat e Drejtorise

-Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te Shoqerise.

*P. Gega*

Ajo ushtron keto kompetenca brenda objektit te Shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe Ligji ua jep shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asambleses se Aksionereve.

Anetaret e Drejtorise perfaqesojne Shoqerine ne marredhenie me te tretet ne Shqiperi dhe jashte saj kundrejte personave fizike apo juridike te se drejtes - private apo publike, organeve te pushtetit lokal, organizmave nderkombetare si dhe kundrejte Gjykatave vendase dhe te huaja.

-Me Statutin prezent i njihet Keshillit Mbikqyres e drejta per tu dhene njerit apo disa anetareve te Drejtorise kompetencen e perfaqesimit te Shoqerise vetem apo se bashku me nje anetar tjetër.

-Anetaret e Drejtorise qe kane kompetencen e perfaqesimit bashkarisht te Shoqerise mund tu ngarkojne disave prej tyre kompetencen e perfaqesimit te vetem per disa operacone speciale apo per disa kategori specifike operacionesh.

#### Neni 14

-Anetaret e Drejtorise emerohen nga Keshilli Mbikqyres qe ngarkon njerin prej tyre me cilesine e Drejtorit te Pergjithshem.

-Anetaret e Drejtorise jane persona fizike dhe mund te zgjidhen edhe jashte bashkesise se Akasionereve.

-Drejtori i Pergjithshem drejton mbledhjen e Drejtorise.

-Ne rast se Drejtori i Pergjithshem mungon apo nuk mund te drejtoje mbledhjen e Drejtorise e zevendeson ne gjithe ushtrimin e kompetencave te tij zevendesit i tij.

#### Neni 15

##### Zevendesimi i Anetareve te Drejtorise

Ne rast se per cdo lloj arrsyetje mbetet bosh vendi i ndonje anetari te Drejtorise detyrimisht duhet qe Keshilli Mbikqyres te zgjedhe perkohesisht zevendesuesin e tij deri sa te plotesohet mandati i anetarit qe mungon dhe te behet emerimi i anetareve te rinj.

#### Neni 16

##### Thirrja e Anetareve te Drejtorise

-Anetaret e Drejtorise mblidhen ne Seline e Shpoqerise te pakten nje here ne muaj ose ne menyre te jashtezakonshme me iniciativen e Drejtorit te Pergjithshem apo te zevendesuesit te tij.

-Anetaret e Drejtorise mund te mblidhen dhe ne cdo vend tjetër jashte apo brenda vendit neqofte se ne mbledhje jane prezent apo perfaqesohen te tere dhe asnjeri prej tyre nuk ka kundërshtim per kryerjen e mbledhjes dhe marrjen e vendimeve.

-Anetaret e Drejtorise mblidhen nga Drejtori i Pergjithshem me ftese, e cila u behet e njohur Anetareve te pakten pese dite para mbledhjes.

Ne ftese duhet medoemos te permenden me qartesi ceshtjet e rendit te dites perndryshe marrja e Vendimeve lejohet vetem kur paraqiten apo perfaqesohen te tere anetaret dhe asnjeri prej tyre nuk ka kundërshtim per marrjen e Vendimeve.

-Mbledhjen e anetareve te Drejtorise mund ta kerkojne 2 (dy) anetare me kerkese e cila i drejtohet Drejtorit te Pergjithshem.

Ky i fundit eshte i detyruar te mbledhe anetaret e Drejtorise brenda 5 (pese) diteve nga parashtrimi i kerkeses para mbledhjes.

Ne kerkese duhet te permenden me qartesi ceshtjet te cilat do te trajtojne anetaret e Drejtorise.

-Ne rast se Drejtori i Pergjithshem refuzon te mbledhe anetaret e Drejtorise, keta brenda afatit te lartepemendur u lejojne anetareve qe fillimisht kerkuan mbledhjen, te rikerkojne brenda 5 (pese) diteve, pas mbarimit te pesediteshit te pare, mbledhjen e anetareve te Drejtorise, duke bere te njohur ftesen ne fjale edhe anetareve te tjere.

#### Neni 17

-Perfaqesimi i anetareve, Pjesemarrja, Quorumi

-Ne rast se nje anetar mungon, ai mund te perfaqesohet nga nje anetar tjeter, i cili ka te drejten e perfaqesimit te nje antari te vetem qe mungon.

-Drejtoria mblidhet vete kur ne te marrin pjese apo perfaqesohen nga  $\frac{1}{2} + 1$  e anetareve te saj.

-Gjithsesi numuri i anetareve prezent nuk mund te jete me i vogel se 2.

-Vendimet e Drejtorise merren me shumicen e thjeshte te anetareve te cilet jane prezent apo perfaqesohen.

#### Neni 18

Procesverbalet e mbledhjeve te Drejtorise

-Drejtoria mban nje regjister per zhvillimin dhe pjesmarrjen e mbledhjeve te tij ne te cilin shenohen ceshtjet e diskutuara, procesverbali i diskutimeve dhe vendimi i marre sipas votimit te bere.

-Procesverbalet e mbledhjeve te Drejtorise mbahen nga Sekretari te cilin e cakton Drejtori i Pergjithshem dhe nenshkruhen nga anetaret te cilet marrin pjese ne mbledhje si dhe nga Sekretari.

-Parashtrohen per regjistrim e publikim Fotokopje te procesverbaleve te mbledhjeve te Drejtorise ne lidhje me te clat legjislacioni shqiptar parashikon rregjistrimin ne Gjykate apo publikimin e tyre, brenda afatit te 20 (njetete) diteve nga dita e mbledhjes se Drejtorise.

#### Neni 19

Shperblimi i anetareve te drejtorise dhe ndalimi i huadhenieve.

-Menyra dhe masa e shperblimit te sejcilit anetar te Drejtorise fiksohet me aktin e emrimit.

-Anetaret e Drejtorise dhe Anetaret e Keshillit Mbikqyres ndalohej te kontraktujne me cilendo forme qe te marrin hua nga Shoqeria, te japin nepermjet saj paradhenie si dhe te behen dorezues apo te garantojne nepermjet saj detyrimet ndaj te treteve.

-Cdo kontrate e bere ne kundershtrim me ndalimet e mesiperme eshte e pavlefeshme.

-I njejti ndalim zbatohet per bashkeshortin, paraardhesit dhe pasardhesit e personave te permendur ne kete Nen.

#### Neni 20

-Pjesemarrja e Anetareve te Drejtorise

-Anetaret e Drejtorise jane pergjegjes ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te dispozitave ligjore ose rregulloreve te zbatueshme, per shkelje te Statutit si dhe per gabimet e bera ne Administrimin e Shoqerise.

26-88



Kreu IV  
Asambleja e Aksionereve  
Neni 21

-Kompetencat e Asamblese se Aksionereve  
-Asambleja e Akasionereve te Shoqerise eshte Organi me i larte i Shoqerise i cili ka te drejte te vendose mbi cdo ceshtje qe ka te beje me Shoqerine.

-Vendimet e saj te vlefeshme detyrojne edhe aksioneret qe mungojne apo nuk jane dakorte me to.

Neni 22

Asambleja e Jashtezakonshme

-Vetem Asambleja e Jashtezakonshme ka kompetenca te ndryshoje Statutin me te gjitha dispozitat e tij si dhe gjithashtu vendos posacerisht mbi ceshtjet e meposhteme:

- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Shtyrjen e afatit, bashkimin me Shoqeri te tjera, ndarjen, ndryshimin ne tjeter forme te Shoqerise dhe mbylljen e Shoqerise.
- Ndryshimin e qellimit te Shoqerise.
- Ndryshimin e menyres se disponimit te fitimeve.

Neni 23

Asambleja e Zakonshme

-Asambleja e Zakonshme eshte organi kompetent i cili merr cdo Vendim tjeter pervec atyre qe permenden ne Nenin e mesiperm dhe konkretisht:

- Zgjedhjen e anetareve te Keshillit Mbikqyres dhe te Eksperteve Kontabel te Shoqerise si dhe miratimin e pageses se tyre.
- Miratimin e bushetit te Shoqerise.
- Disponimin e fitimeve vjetore.
- Procedurat per kryerjen e bashkimit me Shoqeri te tjera, ndarjes, ndryshimit te tjeter forme te Shoqerise dhe mbylljes se Shoqerise.
- Caktimi i likujduesve.
- Si dhe per cdo ceshtje tjeter qe ligji apo Statuti e vendosin si organin e vetem kompetent.

Neni 24

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

-Asambleja e Pergjithshme thirret ne mbledhje te pakten nje here ne vit brenda 6 (gjashte) muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar.

Ky afat mund te zgjatet ne Vendim Gjykate.

-Asambleja e Pergjithshme thirret ne mbledhje nga Keshilli Mbikqyres apo nga Drejtoria.

-Ne mungese ajo mund te thirret gjithashtu nga ekspertet kontabel te autorizuar, nga likujduesit, si dhe nga aksioneret qe zoterojne se bashku 1/10 e kapitalit themeltar.

-Ne raste te vecanta mund te mblidhet Asambleja e Pergjithshme dhe ne vende te tjera pervec Selise se Shoqerise neqoftese paraqiten apo perfaqsohen ne mbledhje, aksioneret dhe te cilet nuk kane asnje kundersiztim per realizimin e mbledhjes dhe jane dakorte per marrjen e Vendimeve.

P. G. R.

#### Neni 25

##### Menyra e njoftimit; Rendi i dites

-Thirrja e mbledhjes se Asamblese se aksionereve behet nepermjet lajmerimit qe botohet ne nje gazete te autorizuar per publikimin e njoftimeve ligjore.

-Njoftimi qe duhet te bjere ne doren e aksionereve apo te njihet prej tyre te pakten 15 (pesembedhete) dite perpara mbledhjes se Asamblese, percakton ditën, orën, dhe vendin ku behet mbledhja si dhe natyren e jashtezakonshme apo te vecante dhe rendin e dites.

-Rendi i dites i mbledhjes se Asamblese se aksionereve percaktohet nga Subjekti qe ka kerkuar zhvillimin e saj dmth (autori i lajmerimit).

Rendi i dites nuk ndyshon deri ne ditën e zhvillimit te mbledhjes.

-Si perjashtim ditën e zhvillimit te mbledhjes ne rendin e dites mund te shtrohet projektrezoluta e paraqitur nga nje ose disa aksionere ose perfaqesues te tyre qe zoterojne 20% te totalit te aksioneve me te drejte vote.

-Asambleja nuk mund te shqyrtoje nje ceshtje qe nuk percaktohet ne rendin e dites.

#### Neni 26

##### Depozitimi i aksioneve, perfaqesimi dhe pjesemarrja ne Asamblene e Pergjithshme

-Aksioneret marrin pjese lirisht ne mbledhjen e Asamblese me regjistrimin e Akasionerit ne regjistrin e aksioneve nominative te Shoqerise, apo me depozitimin ne vendin e treguar ne fletethirrjen e mbledhjes se aksionereve per pruresin apo nga nje certifikate depozitimi e leshuar nga Banka depozituese e ketyre aksioneve.

-Nje aksioner nuk mund te perfaqesohet nga nje tjetër aksioner apo nga bshkeshorti.

-Faturat e depozitimit te aksioneve si dhe dokumentat e legalizimit te perfaqesuesve te Aksionereve duhet ti paraqiten Shoqerise te pakten 5 (pese) dite para mbledhjes se Asamblese.

-Aksioneret te cilet nuk plotesojne kushtet e depozitave 1 dhe 3 te ketij Neni mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblese vetem pas lejes se dhene prej saj.

-Anetaret e Keshillit Mbikqyres, anetaret e Drejtorise dhe ekspertet kontabel te autorizuar mund te marrin pjese ne te gjitha mbledhjet e Asamblese me vota konsultative.

-Ata duhet te njoftohen me shkrim 15 dite perpara mbledhjes se Asamblese.

#### Neni 27

##### Quorumi dhe pjesemarrja ne mbledhjen e zakonshme te Asamblese se Aksionereve

-Asambleja e Zakonshme merr vendime te vlefeshme ne mbledhjen e pare vetem neqofese aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar zoterojne te pakten mbi 70 % e aksioneve me te drejte vote.

-Ne rast se nuk plotesohet ky kusht mbledhja shtyhet duke caktuar ne nje date tjetër dhe ne mbledhjen e dyte nuk caktohet asnje lloj quorumi.

P.P. 81

Neni 28

Quotum i the pjesemarrja ne mbledhjen e jashtezakonshme te Asamblese se Aksionereve

-Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme quhet e vlefshme dhe mund te marre vendim kur ne mbledhjen e pare jane te pranishem apo te perfaqesuar me te drejte vote aksioneret qe zoterojne te pakten mbi 70 % te vleres se aksioneve te Shoqerise.

-Ne rast se nuk realizohet ky kusht, mbledhja nuk zhvillohet dhe shtyhet per tu bere brenda afatit maksimal te dy muajve, kjo me von nga dita e thirrjes se mbledhjes se pare dhe kjo mbledhje e dyte mund te zhvillohet kur jane te pranishem apo te perfaqesuar me te drejte vote aksioneret qe zoterojne  $\frac{1}{4}$  te totalit te vleres se aksioneve te Shoqerise.

-Asambleja e Jashtezakonshme merr Vendim me shumice votash prej mbi 70 % qe u perkasin Aksionereve te pranishem apo te perfaqesuar kusht themelor per vlefshmerine ligjore te tij, ne te kunderten ai eshte akt juridik administrativ absolutisht i pavlefshem.

Neni 29

Kryetari i Asamblese

Kryetari i Asamblese drejton mbledhjen, diskutimet dhe firmos procesverbalin dhe aktet e mbledhjes.

Zgjedhja e Kryetarit te Asamblese behet me shumice te thjeshte votash te aksionereve te pranishem apo te perfaqesuar, qe jane te pranishem.

Neqoftese nuk plotesohet ky kusht; mbledhjen e Asamblese e drejton perkohesishte kryetari i Keshillit Mbikqyres.

Neni 30

Procesverbalet e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Ne cdo mbledhje te Asamblese plotesohet nje evidence pjesemarrjeje.

Ecuria e mbledhjes se Asamblese pasqyrohet ne procesverbal, i cili nenshkruhet nga kryetari dhe sekretari.

Neni 31

Keshilli Mbikqyres

Perberja dhe afati i Keshillit Mbikqyres


-Ne mbledhjen e pare te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve Themelues te Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. me votim unanim dhe 100% te votave, ajo Vendos zgjedhjen e Organeve Drejtuese te saj dhe konkretishte:

-Keshilli Mbikqyres perberbehët nga 3 (tre) anetare dhe me keto funksione:

-Donike	GEGA	Kryetare
-Fran	STERKAJ	N/kryetar
-Ardian	STERKAJ	Anetar

-Ata percaktohen saktesishte ne kete Statut, si dhe kohezgjatja e mandatit te tyre eshte per 4 (kater) vjet qe nga dita e themelimit te Shoqerise dhe mbaron ne daten e percaktuar prej tyre.

-Mbas mbarimit te mandatit te mesiper 2/3 e anetareve te Keshillit te pare Mbikqyres emerohen nga Mbledhja e Zakonshme e Asamblese dhe kohezgjatja e mandatit te tyre eshte per 4 (kater) vjet.





-Një treta (1/3) e anetarve të Keshillit Mbikqyres zgjidhet nga të punësuarit në Shoqëri në mbledhjen e Asamblese së aksionereve e cila ka për qëllim të përcaktuar këto tema.

-Procedura e zgjedhjes bëhet në përputhje me Nenin 110 të Ligjit Nr.7638 datë 04.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare".

-Nëse numuri i anetarve të zgjedhur nga të punësuarit është i barabartë apo më i madh se 2 (dy), specialistet, kuadrot apo personat e ngjajshëm me ta kanë të paktën 1 (një) vend në Keshillin Mbikqyres.

-Anetaret e Keshillit Mbikqyres të zgjedhur nga të punësuarit duhet të kenë firmosur një kontratë pune të paktën 2 (dy) vjetë përpara datës së emrimit në këtë Keshill.

-Ky kusht për vjetërsinë e kontratës nuk kërkohet kur në momentin e emrimit Shoqëria ka më pak se 2 (dy) vjetë që është themeluar.

-Asnjë anetar i Keshillit Mbikqyres nuk mund të jetë Anetar i Drejtorisë.

-Në rast se një anetar i Keshillit Mbikqyres emerohet anetar i Drejtorisë, mandati i tij në Keshillin Mbikqyres perfundon sapo ai të kalojë në funksionin e ri.

-Anetaret e Keshillit Mbikqyres të zgjedhur nga të punësuarit vazhdojnë të kenë cilësinë e të punësuarit në Shoqëri gjatë gjithë kohëzgjatjes së Mandatit të Anetarit të Keshillit Mbikqyres.

-Në rastin e zgjedhjes së Kontratës së Punës të anetarit të Keshillit Mbikqyres me Shoqërinë nderpritet automatikisht edhe Mandati i tij si Anetar.

-Prishja e Kontratës së Punës të anetarit të Keshillit Mbikqyres të zgjedhur nga të punësuarit me përjashtim të rastit kur kjo prishje bëhet me iniciativën e tij shpallet vetëm nga Gjykata, që mbledhet në Sëance urgjente.

-Vendimi ekzekutohet perkohësisht deri sa ai të marrë formën e prere.

-Anetaret e Keshillit Mbikqyres të zgjedhur nga personeli mund të shkarkohen vetëm për fajë në ushtrimin e Mandatit të tyre dhe me Vendim të Gjykatës që mbledhet në Sëance urgjente me kërkesën e shumicës së Anetarëve të Keshillit Mbikqyres.

-Vendimi ekzekutohet perkohësisht deri sa ai të marrë formën e prere.

-Të gjithë anetaret e Keshillit Mbikqyres, aksionerë apo jo mund të rizgjidhen serishe.

#### Neni 32

##### Kompetencat e Keshillit Mbikqyres

-Keshilli Mbikqyres ushron kontroll të vazhdueshëm ndaj Drejtorisë për administrimin e Shoqërisë nga ana e saj.

-Keshilli Mbikqyres ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikimet dhe kontrollet që ai i cmon të arryeshme dhe të kërkojë të njihet me dokumentat që ai i gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij.

-Drejtorja i paraqet raportin e Keshillit Mbikqyres të paktën një herë në 3 muaj.

-Drejtorja i paraqet Keshillit Mbikqyres brenda 3 (tre) muajve nga mbyllja e vitit financiar dokumentat që përcaktohen në Nenin 130 Paragrafi 2 të Ligjit Nr.7638 datë 04.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare", me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

-Keshilli Mbikqyres i paraqet Asamblese verejtjet e tij mbi raportin e Drejtorisë si dhe ato mbi llogaritë e vitit financiar.

*B. S.*

-Jep miratimin e tij me autorizim paraprak per kryerjen e marreveshjeve te me postme.

-Te gjitha marreveshjet qe behen ndermjet nje shoqerie dhe nje anetari te Drejtorise apo te Keshillit Mbikqyres te kesaj Shoqerie.

-Marreveshjet me te cilat nje nga personat e lartepemendur lidhet indirekt apo ne te cilat ai lidhet me Shoqerine nepermjet nje personi ndermjetes.

-Marreveshjet ndermjet Shoqerise dhe nje subjekti tjetër ekonomik te cfaradoshem ne rast se nje nga anetaret e Drejtorise apo te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise eshte pronar, aksioner i pa kufizuar, administrator apo anetar i Drejtorise se subjekti tjetër ekonomik, konsiderohen si pronare personat qe kontrollojne subjektin ekonomik sipas Nenit 219 te Ligjit Nr.7638 date 04.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

-Rregullat e ketij Neni nuk zbatohen per marrveshjet e bera per operacionet e perditeshme dhe te zbatuara ne kushte normale.

-Anetari i interesuar i Drejtorise apo i Keshillit Mbikqyres duhet te informoje Keshillin Mbikqyres sapo vihet ne dijeni rreth marrveshjeve qe u permenden ne Paragrafin 5 te ketij Neni.

-Kryetari i Keshillit Mbikqyres njofton ekspertet kontabel te autorizuar per te gjitha marreveshjet e autorizuar dhe ia dergon ato per miratim Asamblese.

-Mbi marrevshjet ne fjale ekspertet kontabel te autorizuar paraqesin raport te vecante ne Asamble e cila merr Vendime per kete Raport.

-I interesuari nuk merr pjese ne votim dhe aksionet e tij nuk merren ne konsiderate per llogaritjen e quorumit dhe te shumices.

-Marreveshjet e permendura ne Paragrafin 5 te ketij Neni, te cilat nuk miratohen nga Asambleja vazhdojne te detyrojne Shoqerine perballe personave te trete pervec rastit kur ato anulohen per arrsyeshme mashtrimi.

-Marrvshjet e permendura ne Paragrafin 5 te ketij Neni dhe te perfunduara pa autorizim paraprak te Keshillit Mbikqyres mund te anulohen ne rast se ato kane patur pasoja te demeshme per Shoqerine.

-Padia per pavlefshmerin ngrihet me Vendim te Asamblese brenda afatit te 3 (tre) vjeteve nga data e marreveshjes, apo nga data e zbulimit te saj ne se marrveshja ka qene e fshehur.

#### Neni 33

Kryetari dhe Zevendeskrjetari i Keshillit Mbikqyres

-Keshilli Mbikqyres zgjedh nga gjiri i tij nje Kryetar dhe nje Zevendeskrjetar.

-Kryetari dhe Zevendeskrjetari i Keshillit mbikqyres jane Persona Fizike dhe nuk mund te zgjidhen ndermjet perfaqesuesve te Personave Juridik, perndryshe emrimi i tyre eshte i pavlefshem.

#### Neni 34

Zevendesimi i Anetarit te Keshillit Mbikqyres

-Ne rastin e vendeve bosh qe krijohen nga vdekja apo doreheqja e nje apo disa anetarve te Keshillit Mbikqyres, Anetaret e tjere duke qene te pakten 3 (tre), mundet per periudhen ndermjet dy mbledhjeve te Asamblese te bejne emerime te perkoheshme.

1. 6. 8

-Mbledhja e rradhës së Asamblesë së Zakonëshme ratifikon emerimet e bera në periudhën e ndërmjetme si dhe zgjedh anëtarin e ri të Keshillit Mbikqyres të njëjtin apo tjetër person me mandat dy vjeçar për Keshillin e parë ose 3 vjeçar për Keshillat e mëpasëm.

-Zëvendësimi i anëtarit që mungon kur ai është zgjedhur nga personeli rregullohet nga dispozitat e Nenit 116 të Ligjit Nr.7638 datë 04.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare".

#### Neni 35

##### Thirrja e Keshillit Mbikqyres

-Keshilli Mbikqyres mblidhet në Seline të Shoqërisë të paktën një herë në çdo 3 (tre) muaj apo në raste të veçanta me iniciativën e Kryetarit të tij.

-Keshilli Mbikqyres mund të mblidhet edhe në çdo vend tjetër brenda apo jashtë vedit me kusht që në këtë mbledhje të paraqiten apo të përfaqësohen të gjitha anëtarët e tij dhe të tjerë të bën dakortë për realizimin e mbledhjes dhe marrjen e Vendimeve prej saj.

-Keshilli Mbikqyres mblidhet nga Kryetari i tij me njoftim, i cili u dërgohet anëtarëve të paktën 5 ditë para seances së mbledhjes.

#### Neni 36

##### Përfaqësimi i anëtarëve, Shmëca, Quorumi

-Anëtarit që mungon mund të përfaqësohet nga një Anëtar tjetër.

-Çdo anëtar përfaqëson vetëm një anëtar që mungon.

-Keshilli Mbikqyres nuk mund të marrë Vendime të vlefshme pa qenë e pranishme të paktën gjysma e anëtarëve të tij.

-Asnjëherë numuri i anëtarëve present nuk mund të jetë më i vogël se tre respektivisht në se behet fjale për Keshillin e parë apo atë të mëpasëm.

-Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve presentë ose të përfaqësuesve të tyre.

-Vota e Kryetarit është përcaktuese në rast rezultati të barabartë votash.

#### Neni 37

##### Procesverbali i mbledhjeve të Keshillit Mbikqyres

-Keshilli Mbikqyres mban një regjistër për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e mbledhjeve të tij në të cilin shënohen çështjet e diskutuara, procesverbali i diskutimeve dhe Vendimi marrë sipas votimit të bërë.

-Procesverbali i mbledhjes së Keshillit Mbikqyres mbahet nga sekretari të cilin e cakton Kryetari dhe nënshkruhet nga Anëtarët.

#### Neni 38

##### Shpërblimi i Anëtarëve të Keshillit Mbikqyres.

-Anëtarëve të Keshillit Mbikqyres mund t'u jepet shpërblimi i cili caktohet nga Asambleja e Përgjithëshme e Aksionereve

-Çdo shpërblim tjetër i Anëtarëve të Keshillit Mbikqyres rëndon Shoqërisë neqoftese është miratuar me Vendim të Posacem të mbledhjes së zakonëshme të Asamblesë.

*P. G. J.*



Kreu i V  
Kontrolli i Shoqerise  
Neni 39

Emerimi i eksperteve kontabel

-Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen nga Asambleja e Zakonshme ne mbledhjen e saj me perjashtim te rasteve te parashikuara ne Nenet 84 dhe 93 te Ligjit Nr.7638 date 04.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

-Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen per nje vit financiar nga Asambleja e Zakonshme, e cila cakton dy eksperte dhe dy zevendesues duke caktuar sipas rastit dhe shperblimin e tyre.

-Brenda afatit te 5 (pese) diteve nga mbledhja e Asamblese e cila cakton ekspertet kontabel shoqeria duhet tu njoftoje (eksperteve) emerimin e tyre.

-Ne rast se nuk e kundershtojne kete emerim shprehimisht brenda afatit 5 (pese) diteve quhet qe e kane pranuar dhe kane te gjitha te drejtat dhe detyrat e ekspertit kontabel.

-Emerohet Eksperti kontabel i miratuar eshte emeruar Zoti Hazis DRAGOVEJA.

-Nuk mund te caktohen eksperte kontabel te autorizuar personat qe permenden ne Nenet 168 dhe 169 te Ligjit Nr.7638 date 04.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

Neni 40

Kompetencat e eksperteve kontabel

-Ekspertet kontabel te autorizuar kane per detyre te perhershme duke perjashtuar cdo nderhyrje ne administrim te verifikojne librat e llogarise dhe fondet e Shoqerise si dhe te kontrollojne pershtatjen e kontabilitetit te saj me legjislacionin ne fuqi.

-Ata garantojne qe llogarite vjetore jane te rregullta e te hartuara me sinqeritet dhe japin nje pasqyrim besnik te rezultatit te operacioneve te vitit te kaluar financiar si dhe te gjendjes financiare e te trashegimise ne fund te vitit financiar.

-Verifikojne gjithashtu sinqeritetin dhe perputhjen me llogarite vjetore te infomacioneve te dhena ne raportin e administrimit nga ana e Drejtorise dhe ne dokumentat qe u jane dhene aksionereve mbi gjendjen financiare dhe llogarite vjetore.

-Ekspertet kontabel te autorizuar kane per detyre te informojne Drejtorine dhe Keshillin Mbikeqyres mbi kontrolliet dhe verifikimet qe kane kryer, sontazhet e ndryshme qe kane bere, parregullshmerite dhe pasaktesite qe kane zbuluar, verejtjet dhe perfundimet mbi rezultatet e vitit financiar.

-Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e Drejtorise, e cila mbyll llogarite e vitit te kaluar financiar si dhe ne gjitha mbledhjet e Asamblese se Aksionereve.

-Ne mbledhjen e pare te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve Themelues te Shoqeria Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. me votim unanim dhe 100% te votave, ajo Vendos zgjedhjen e Organeve Drejtuese te saj.

P. G. J.



Kreu VI  
Raportet vjetore  
Neni 41

-Aktiviteti ekonomik - financiar i Shoqerise ndahet ne periudha te cilat zgjasin 12 (dymbjedhete) muaj, kohe e cila si rregull fillon nga data 1 Janar deri me daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik me perjashtim te periudhes se pare e cila fillon me daten e themelimit te Shoqerise dhe perfundon me daten 31 Dhjetor te vitit perkates.

Neni 42  
Raportet vjetore

-Ne mbylljen e cdo viti financiar Drjtoria ben inventarin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin.

-Raporti i administrimit pasqyron gjendjen e Shoqerise gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara te saj, veprimtarite e rendesishme qe jane zhvilluar gjate periudhes nga data e mbylljes se vitit financiar deri ne daten ne te cilen eshte hartuar ky raport.

Neni 43  
Dividenti i Shoqerise

-Fitimi neto (Dividenti) i Shoqerise perlogaritet mbasi nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar te jene zbritur humbjet e nevojsheme te vitit te mepershem, vlera e shlyerjes se plote te detyrimeve taksuale tatimore apo fiskale, e cdo lloj detyrimi tjeter i Shoqerise ndaj te treteve si dhe lenien menjane te nje shume te pakten 1/20 te fitimit te rezervuar, e cila destinohet per formimin e nje fondi reserve te quajtur Rezerva e domosdoshme

-Kjo lenie menjane nuk eshte me e detyrueshme kur Rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

-Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidencimit te ekzistences se shumave qe do te shperndahen asambleja percakton pjesen qe u takon aksionereve ne forme dividendesh..

Neni 44  
Ndarja e Dividentit

-Ndarja e Dividentit behet brenda afatit 1 (nje) mujor prej dites se marrjes se Vendimit nga Asambleja ne mbledhjen e saj te zakoneshme, ne te cilen ajo miraton llogarite vjetore.

Kreu i VII  
Prishja dhe likuidimi i Shoqerise  
Neni 45

Rastet e prishjes se Shoqerise

-Ne plotesimin e afatit per te cilin ajo eshte krijuar.

-Me Vendim te mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve te saj sipas kushteve ligjore te ushtrimit te kesaj te drejte vendimore.

-Kur vertetohet nje nga rastet e parashikuara ne Ligjin per falimentimin e Shoqerive Aksionere.

-Perqendrimi i aksioneve ne nje dore te vetme nuk eshte arrsyje per prishjen e Shoqerise.

-Neqoftese si rrjedhim i humbjeve te konstatuara ne dokumentat kontabile Kapitalit e veta te Shoqerise behen me te vogela se gjysma e kapitalit themeltar. Drejtoria detyrohet brenda kater muajve nga miratimi i bilancit financiar kur eshte zbuluar kjo humbje te therrase mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme me qellim qe te merret Vendimi nese ka vend per prishjen e Shoqerise.

Neni 46

Likujdimi

-Shoqeria eshte ne likujdim e siper qe ne meomentin e prishjes se saj per cfardo lloj arresye me perjashtim te rastit te parashikuar ne Nenin 10 te Ligjit Nr.7638 date 04.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

-Emertimi i Shoqerise pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper"

-Ky shenim dhe emri i likujduesve duhet te figurojne ne te gjitha aktet e nxjerra nga Shoqeria dhe qe u drejtohen te treteve.

-Ekzistenca e Shoqerise si Person Juridik mbetet per nevojat e likujdimi deri ne perfundim te ketij procesi.

-Drejtoria kryen detyra likujduesi deri sa te caktohen nga Asambleja e Pergjithshme e aksionereve.

-Likujduesit qe caktohen nga Asambleja e Pergjithshme mund te jene dy deri kater veta, aksionere apo jo, dhe ushtrojne te tera kompetencat e Drejtorise qe kane lidhje me stadin dhe proceduren e likujdimi.

-Emertimi i likujduesve automatikisht sjell mosfuqine e kompetencave te Drejtorise dhe te eksperteve kontabel.

-Likujduesit qe caktohen nga Asambleja e Pergjithshme kane per detyre te bejne menjehere bilancin perfundimtar financiar te pasurise se Shoqerise.

-Asambleja e Pergjithshme e aksionereve ruan te tera te drejtat e saj gjate stadi dhe procedures se likujdimi.

Dispozitat e fundit

Neni 47

-Organet Drejtuese te Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. jane:

-Asambleja e Aksionereve (e Jashtezakonshme dhe e Zakonshme).

-Keshilli Mbikqyrres

-Drejtoria

-Drejtori i Pergjithshem Zt. Paulin Pjeter GEGA

Neni 48

Keshilli Mbikqyrres perberbehel nga 3 (tre) anetare dhe me keto funksione:

-Donike GEGA Kryetare

-Fran STERKAJ N/kryetar

-Ardian STERKAJ Anetar

Neni 49

-Emerohet Eksperti kontabel i miratuar Zoti Hazis DRAGOVEJA.

*J. R. S.*

Neni 50

-Ky Statut i Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A. me Seli ne Beltoje, Komuna Berdisht, Shkoder, u perpilua ne 4 (kater) kopje me permbajtje dhe vlera te njejt juridike, ne gjuhen Shqipe, dhe nenshkruhet pa vretje nga Aksioneri i vetem Themelues, duke e vene: emrin, mbiemrin dhe nenshkrimin original ne te gjitha kopjet, Autentiteti i te cilit eshte i vertetuar ligjerishte nga Noteri.

Aksioneri i vetem Themelues ne Mledhjen e pare te Asamblese se  
Pergjithshme te  
Shoqerise Anonime "GENKLAUDIS" SH.A.

Shkoder me, 15.06.2007

Paulin Pjeter GEGA

PAULIN GEGA  
P. GEGA